

DOKUMENT I POLITIKAVE

*Instrumentet financiare
të BE-së për kulturë:
Sfidat dhe mundësitë për
sektorin e pavarur të
kulturës në Kosovë*

Janar 2015, Prishtinë



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura

Rrjeti i organizatave të pavarura të
kulturës të Kosovës

www.forumikulturor.net



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës
www.forumikulturor.net

Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme International Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian”

DOKUMENT I POLITIKAVE

Instrumentet financiare të BE-së për kulturë: Sfidat dhe mundësitë për sektorin e pavarur të kulturës në Kosovë

Autore:

Agon Maliqi



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



SWEDEN

TABELA E PËRMBAJTJES

ARSYESHMËRIA E DOKUMENTIT TË POLITIKËS: PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM FINANCIMI I BE-SË PËR SEKTORIN E PAVARUR TË KULTURËS?

PASQYRË E SHKURTËR: INSTRUMENTET FINANCIARE TË BE-SË QË JANË RELEVANTE PËR SEKTORIN E PAVARUR TË KULTURËS NË KOSOVË.

ANALIZA E GJENDJES: EFEKTSHMËRIA E INSTRUMENTEVE FINANCIARE TË BE-SË NË PËRKRAHJEN E REKOMANDIMEVE TË SEKTORIT TË PAVARUR TË KULTURËS

HYRJJE

Arsyeshmëria e dokumentit të politikës: Pse BE-ja është e rëndësishme për sektorin e pavarur të kulturës?

Qytetarët e Kosovës pothuajse plotësisht pajtohen rreth aspiratave të tyre për anëtarësim në Bashkim Evropian (BE). Së këndejmi, ekziston një besim i gjerë dhe i arsyetuar se hyrja në BE do të sjell shumë dobi. Megjithatë, në shumicën e sferave të jetës diskursi për integrim në BE nuk karakterizohet shumë me diskutim se cilat janë këto dobi praktike dhe me mënyrat se si mund të arrihen ato.

Procesi i integritimit kryesisht trajtohet si proces i plotësimit të kushteve teknike apo politike që nevojiten për anëtarësim dhe jo si një proces i brendshëm i reformave dhe masave, përmes të cilave do t'i mundësohej Kosovës që të bëhet anëtare dhe t'i gëzojë të mirat e anëtarësimit, duke përfshirë edhe përkrahjen nga shumë mekanizma ekzistues për përkrahje financiare.

Qasja e Kosovës në fonde të BE-së për kulturë është një çështje që nuk ka qenë temë e diskutimeve thelbësore publike, madje edhe në mesin e akterëve të kulturës dhe komunitetit të kulturës. Kjo kryesisht ndodh për shkak të mungesës së informatave lidhur me mundësitë përtej kufijve të Kosovës. Por një faktor tjetër i rëndësishëm është fakti që skena e kulturës që është e privuar nga kapacitetet e duhura financiare dhe teknike, në përgjithësi funksionon sipas mënyrës ad-hok dhe prej projektit në projekt, me theks të paktë në planifikimin afatgjatë dhe strategjik. Megjithëkëtë, nevoja për një qasje më strategjike dhe afatgjatë për zhvillimin e skenës së kulturës dhe të operatorëve të kulturës shtrën nevojën për një debat më të gjerë lidhur me atë se si mund të arrihet kjo.

Operatorët e pavarur të kulturës në Kosovë, edhe pse dinamikë dhe me ambicie për t'u rritur,

ballafaqohen me shumë sfida që pikësepari shkaktohen nga fuqia e kufizuar blerëse për artin dhe kulturën në tregun vendor. Andaj, në afat të shkurtër dhe të mesëm kjo bën operatorët e kulturës që të mbështetën shumë në përkrahjen financiare nga buxheti i qeverisë dhe donatorët. Derisa institucionet publike të kulturës marrin grante vjetore nga buxheti i Kosovës për të mbuluar si kostot operacionale, ashtu edhe ato të aktiviteteve (sado të pamjaftueshme që mund të jenë), sektori i pavarur i kulturës mbështetet në masë të madhe në përkrahjen e donatorëve dhe në sponsorizimin e sektorit privat. Kontributet e qeverisë janë të vogla. Për kokë banori, Kosova shpenzon më pak për kulturë sesa vendet e krahasueshme me të, siç janë: Moldavia, Gjeorgjia, Maqedonia dhe Serbia.¹

Si donatori më i madh në Kosovë,

¹ Pozhegu, Dren. "Politikat e kulturës dhe ndarjet buxhetore për kulturë në Kosovë" – Forumi Kulturor, Tetor 2014. http://www.forumikulturor.net/repository/docs/Cultural_Policies_and_Budget.pdf

Bashkimi Evropian luan dhe mund të luaj rol edhe më të madh në këtë drejtim. Aktualisht ekzistojnë disa instrumente financiare të BE-së që janë relevante për operatorët e kulturës në Kosovë dhe përmes të cilave mund të pranohet përkrahja financiare. Në pjesën tjetër (të dytën) të këtij dokumenti të politikave do të paraqitet një pasqyrë e shkurtër e specifikave të tyre. Po kështu, duhet të theksohet se ka shumë institucione të tjera në mbarë Evropën dhe programe zbatuese që përkrahin sektorin e kulturës, siç është Këshilli i Evropës apo Fondacioni Evropian për Kulturë (FEK). Sido që të jetë, fokusi i këtij dokumenti do të vihet në instrumentet financiare që janë pjesë e kornizës institucionale të Bashkimit Evropian.

Pjesa e tretë e këtij dokumenti përmban analizën e efektshmërisë së këtyre mekanizmave në përkrahjen e sektorit të pavarur të kulturës, me theks të veçantë në

efektshmërinë e tyre lidhur me kapacitetet afatgjata për sigurimin e konkurrueshmërisë në nivel evropian. Pjesa e katërt dhe e fundit përmban disa rekomandime për të gjitha palët me interes – Komisionin Evropian, Qeverinë e Kosovës dhe për palët nga fusha e kulturës – lidhur me disa nga masat kryesore që nevojiten për përmirësimin e ndërveprimit mes sektorit të pavarur të kulturës dhe Komisionit Evropian.

Pasqyrë e shkurtër: Instrumentet financiare të Bashkimit Evropian që janë relevante për sektorin e pavarur të kulturës në Kosovë.

Evropa krijuese

Programimi kulturor dhe i ndihmës financiare i BE-së menaxhohet nga Drejtoria e Përgjithshme (DP) për arsim dhe kulturë e Komisionit Evropian. Kjo Drejtori është degë ekzekutive e BE-së (ekuivalent i një qeverie kombëtare) dhe ka mandat shtatëvjeçar. Në mandatin e kaluar 2007-2013, kur DP udhëhiqej

nga Androulla Vassiliou nga Qipro, mbështetja për sektorin e kulturës ishte kanalizuar përmes Programit kulturor.

Gjatë kësaj periudhe operatorët kulturorë nga Kosova nuk kishin të drejtë për mbështetje financiare në kuadër të kësaj skeme, edhe pse në bazë të definicionit skema ka qenë e supozuar të jetë e hapur për të gjithë kandidatët dhe shtetet kandidate potenciale. Arsyja për këtë, në veçanti gjatë mandateve të viteve të mëhershme, ishte fakti që statusi politik i Kosovës nuk ishte zgjidhur. Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, u desh ca kohë deri sa është sqaruar modaliteti i marrëdhënieve formale me Komisionin Evropian, pasi që Kosova u përball me pengesa nga gjashtë shtete të BE-së, të cilat nuk e njohin pavarësinë e saj.

Megjithatë, edhe pse Kosova ka arritur të vendos marrëdhënie kontraktuale me BE-në (p.sh, përmes Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, e cila pritet të zyrtarizohet së shpe-

jtij), qasja në Programin kulturor ishte ende e pamundur. Disa operatorë kulturorë nga Kosova - Teatri Oda, Multimedia, Dokufest, Skena Up - kanë marrë pjesë në projekte dhe programet e financuara përmes Programit kulturor, por këtë e kanë bërë vetëm si partner të operatorëve kulturorë evropianë me rastin e zbatimit të aktiviteteve të caktuara. Në mandatin e tanishëm të KE-së, së bashku me DP për arsim dhe kulturë drejtuar nga Jan Truszczy si, instrumenti financiar për sektorin krijues për periudhën 2014-2020 është kanalizuar përmes programit paksa të modifikuar dhe rimodeluar Programi i Evropës kreative. Baza juridike e këtij Programi është Rregullorja e BE-së nr. 1295/2013 e Parlamentit Evropian.² Buxheti i përgjithshëm financiar për periudhën përkatëse është 1.46 miliard €. Programi është një shkrirje e programeve të mëparshme për kulturë e media dhe përbëhet prej dy nënprogrameve: i) Kultura dhe ii) MEDIA si dhe një dege ndërsektoriale.

Ashtu si është shënuar në faqen e internetit të KE-së, nënprogramet e kulturës më konkretisht mbështeten nga:⁵

- Bashkëpunimi mes organizatave kulturore dhe krijuese nga vende të ndryshme;

- Iniciativa për përkthime dhe promovime të veprave letrare në të gjithë Bashkimin Evropian;

- Rrjetet ndihmëse dhe kulturore, si dhe sektori krijues për operim konkurrues dhe ndër-shtetëror;

- Krijimi i platformave për promovimin e artistëve dhe simulimi i programit evropian për kulturë e punë artistike.

Megjithatë, operatorët kulturorë nga Kosova ende nuk kanë të drejtë të aplikojnë për fonde madje as për Programin 2014-2020, edhe pse ka bazë ligjore për një gjë të tillë. Rregullorja për krijimin e Programit për Evropën krijuese 2014-2020, parasheh në pikën 22 që “vendet anëtare, vendet candidate dhe vendet candidate potenciale të përfitojnë nga një strategji e paraadimit,

ku dhe vendet e mbuluara në kuadër të Politikës evropiane të fqinjësisë duhet të jenë në gjendje që të marrin pjesë në Program, përpos në rastet kur kemi të bëjmë me instrumentet garantuese.”⁴

Siç është theksuar, Kosova është shtet potencial kandidat, i cili tanimë ka krijuar lidhje formale me BE-në dhe pritet të nënshkruajë Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit (MSA). Megjithëkëtë, qasja në programet e financimit, siç është ai i Evropës Kreative, nuk është automatike, por duhet të paraprihet nga nënshkrimi i marrëveshjes kornizë mes BE-së dhe shteteve candidate që dëshirojnë të marrin pjesë në të. Këtu përfshihet edhe pagesa e tarifës për pjesëmarrje nga çdo vend që në të ardhmen pritet të bëhet anëtar i BE-së.

Siç ilustron në tabelën 1 më poshtë, të gjithë fqinjët e Kosovës kanë nënshkruar marrëveshje të tilla për pjesëmarrje në program-

in Evropa Kreative në qershor dhe korrik të vitit 2014, duke përfshirë Shqipërinë², Bosnjën³, Maqedoninë⁴, Malin e Zi⁵ dhe Serbinë⁶. Në tabelën e mëposhtme ilustron llojet e nënprogrameve, për të cilat shtetet do të kenë të drejtën e aplikimit, si dhe gjithsej kontributin financiar në vit, që përcaktohet në kuadër të negociatave mes KE-së dhe shtetit aspirues, dhe kryesisht ndërlidhet me madhësinë e vendit.

2 Marrëveshja kornizë: KE-Shqipëria. http://ec.europa.eu/programmes/creative-europe/opportunities/documents/agreement-albania_en.pdf

3 Marrëveshja kornizë: KE-Bosnja. http://ec.europa.eu/programmes/creative-europe/opportunities/documents/agreement-bih_en.pdf

4 Marrëveshja kornizë: KE-Maqedonia. http://ec.europa.eu/programmes/creative-europe/opportunities/documents/agreement-fyrom_en.pdf

5 Marrëveshja kornizë: KE-Mali i Zi. http://ec.europa.eu/programmes/creative-europe/opportunities/documents/agreement-montenegro_en.pdf

6 Marrëveshja kornizë: KE-Serbia. http://ec.europa.eu/programmes/creative-europe/opportunities/documents/agreement-serbia_en.pdf

Shteti	Muaji i nënshkrimit të marrëveshjes	1) Nënprogrami i kulturës 2) Lloji ndëresektoral	Programi i MEDIAS	Kontributi financiar (në vit)
Serbia	Korrik 2014		Në pritje të përcaktimit	445,000 €
Mali i Zi	Korrik 2014		Në pritje të përcaktimit	60,000 €
Maqedonia	Korrik 2014		Në pritje të përcaktimit	120,000 €
Shqipëria	Qershor 2014		Në pritje të përcaktimit	150,000 €
Bosnja	Qershor 2014			205,000 €
Kosova	X	X	X	X

Ka shumë keqkuptime dhe keqinformime brenda akterëve të kulturës dhe të politikave në Kosovë lidhur me atë se pse marrëveshja kornizë me Programin e kulturës ende nuk është nënshkruar. Gjatë intervistave me palë të ndryshme me interes është vërejtur perceptimi se problemi ka qenë politik dhe i ndërlidhur me statusin juridik të Kosovës. Megjithatë, për shumicën e këtyre palëve me interes arsyeja

e saktë ishte e paqartë, duke pasur parasysh faktin që procesi i MSA-së dhe ndërveprimet e tjera formale mes BE-së dhe Kosovës janë në vazhdim e sipër.

E vërteta është se ekziston baza juridike dhe vullneti politik për mundësimin e pjesëmarrjes së Kosovës në programe të BE-së. Në Dokumentin e fundit të Strategjisë indikative për IPA II (2014-2020),

të publikuar në gusht të vitit 2014, theksohet se sa i përket Komisionit Evropian “pjesëmarrja e Kosovës në programet relevante të BE-së në fushën e arsimit, hulumtimit dhe kulturës do të inkurajohet.”⁷ Megjithatë, për të nënshkruar marrëveshjet kornizë për programe specifike, Kosova do të ketë nevojë që fillimisht të nënshkruajë një marrëveshje më të gjerë kornizë me Bashkimin Evropian lidhur me “parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Kosovës në programet e Bashkimit Evropian.” Kjo është e ashtuquajtura marrëveshja “amë”, përmes së cilës mundësohet pjesëmarrja në programe specifike.

Burimet e intervistuar për këtë dokument të politikave kanë theksuar se nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje kornizë “amë” aktualisht është duke u bllokuar për arsye politike.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshje-

⁷ Komisioni Evropian. Instrumenti i paraaderimit II (IPA II). “Dokumenti indiktiv i strategjisë për Kosovë 2014-2020). http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20140919-csp-kosovo.pdf

je kërkon shumicën e kualifikuar të shteteve anëtare të BE-së, që do të thotë se madje do të mund të kalonte edhe pa votën e atyre shteteve anëtare, të cilat nuk e kanë njohur Kosovën. Megjithatë, këto të njëjta burime konfirmuan se marrëveshja nuk është nënshkruar sepse Kosova paralelisht është duke negociuar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit, e cila kërkon konsensus dhe miratim nga të gjitha shtetet anëtare. Marrëveshja kornizë nuk është nënshkruar për shkak të frikës se një hap i tillë “i njëanshëm” pa pëlqimin e shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën do ta rriste kundërshtimin në mesin e tyre, duke e rrezikuar kështu MSA-në, e cila politikisht është shumë më e rëndësishme. Fati i Marrëveshjes kornizë rrjedhimisht është i lidhur me fatin e MSA-së.

Kultura për të gjithë

Fakti që Kosova nuk ka pasur të drejtë të merr pjesë në Programin për kulturë (2007-2013) ka luajtur një rol të rëndësishëm në ndikimin që në vitin 2010 të fillohet me programin Kultura për të gjithë brenda Zyrës ndërlidhëse të BE-së në Kosovë. Ky program është i vetmi program specifik për kulturë që KE-ja ka krijuar brenda zyrave të saj në një vend të përafrimit.

Intervistat me palët me interes që janë të njohuar me ngjarjet tregojnë se në mes të tjerash programi është konsideruar që ofron një urë të ashtuquajtur financiare në mënyrë që sektori i kulturës të fitojë përvoja dhe t'i fuqizojë kapacitete deri në heqjen e pengesave juridike për aplikim në programe për mbarë BE-në. Një arsye tjetër e rëndësishme ishte që Zyra ndërlidhëse e BE-së shpesh ka pranuar shumë kërkesa për përkrahje të aktiviteteve kulturore, por nuk ka pasur skemë specifike, nga a e cila do të mund të

kanalizonte këtë përkrahje.

Hulumtimet tregojnë se institucionet e qeverisë, siç është Ministria e Kulturës, kanë pasur interes dhe kanë luajtur rol në krijimin e programit. Ato e kanë bërë një gjë të tillë jo vetëm për shkak të impulsit financiar që do t'i jepte sektorit, por edhe për shkak se një qasje më e strukturuar ndaj përkrahjes së BE-së për sektorin e kulturës do të mundësonte bashkërendim dhe këmbim më të mirë të informatave mes donatorëve dhe institucioneve publike për projektet e kulturës dhe operatorët që përkrahen.

Programi Kultura për të gjithë ka filluar në vitin 2010, dhe aktualisht është në fazën e tretë dhe përfundimtare dyvjeçare, e cila do të përfundojë në vitin 2016. Programi ka dy komponentë kryesorë për përkrahje të granteve: 1) përkrahje për operatorët e kulturës dhe ngjarjet kulturore të organizuara në Kosovë dhe ; 2) Promovimi i këmbi-

meve kulturore ndërkomunitare dhe brendakomunitare.

Brenda shtyllës së tij të parë, programi

Në kuadër të programit Kultura për të gjithë janë përkrahur kryesisht OJQ-të dhe festivalet e kulturës të konsoliduara dhe të njohura, duke ua dhënë atyre një grant vjetor pothuajse të garantuar dhe shumë të nevojshëm, i cili u ka mundësuar të kenë në hapësirë më të madhe manovrimi dhe t'i përqendrojnë përpjekjet për grumbullim të fondeve në drejtime të tjera. Grantet nga jo shtyllë kanë pasur shumën prej 5,000 € deri në 9,000 €. Në shtyllën e dytë, kryesisht janë përkrahur projektet e vogla në komunitete lokale, të cilat kanë pasur dimensionin e fuqizimit për komunitetet e cenushme dhe kanë kultivuar komunikimin ndërëtnik. Grantet nga kjo skemë kanë qenë më të vogla, gjegjësisht prej 2,000 € deri në 3,500 €.

Mekanizimi për shoqërinë civile OJQ-të që merren me fushën e kulturës tani ka kohë që kanë të drejtë të marrin përkrahje përmes Mekanizimit për shoqërinë civile, i cili menaxhohet nga Zyra ndërëlidhëse e KE-së në Prishtinë. Ky mekanizëm është funksional tash e disa vite, dhe financohet përmes Instrumentit të Paraaderimit (IPA). Ky fond zakonisht e ka buxhetin prej 1.1 milion €, ndërsa shuma për IPA-n e ardhshme 2013 është më e vogël.⁸

Qëllimi i këtij mekanizimi është “dhënia e kontributit për demokraci, të drejta të njeriut dhe sundim të ligjit, si dhe përkrahja në procesin e integritit në BE përmes pjesëmarrjes aktive të shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes dhe të politikëbërjes në të gjitha nivelet e qeverisjes.” Rrjedhimisht, llojet e aktiviteteve që mund të përkrahen përmes këtij mekanizimi janë ato

8 Annual Programme for Kosovo* under the IPA Transition Assistance and Institution Building Component for 2013, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/kosovo/ipa/2013/20130122_en_annexe_acte_autonome_kosovo_2013.pdf

që përdorin kulturën për cilindo prej qëllimeve të lartpërmendura. Forumi kulturor është një prej përfituesve të mekanizimit për angazhime në politika të avokimit për kulturë.

Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (IEDDNj) Komisioni Evropian gjithashtu ka edhe instrumente të tjera financiare që janë globale dhe tematike dhe për të cilat ekziston kuota për Kosovë. Këto fonde tematike nuk janë domosdo specifike për kulturë, por mund të shfrytëzohen nga operatorët e kulturës që punojnë tematikisht në një fushë apo në tjetrën.

Një skemë e tillë është Instrumenti Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (IEDDNj), përmes të cilit mund të përkrahen shoqatat vendore të kulturës në shfrytëzim të kulturës për përkrahje të demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Shuma e fondit të IEDDNj-

së në dispozicion për Kosovë për vitin 2014 ka qenë 800.000 €. Operatorët e kulturës kanë të drejtë aplikimi në skemën e lotit të katërt, përmes së cilës tentohet “avancimi i dialogut me komunitetin serb, duke promovuar të drejtat e njeriut dhe reformën demokratike.”

Një projekt i tillë që ka fituar përkrahje nga kjo skemë ka qenë “Teatri Forum për Kosovë”, i cili është realizuar nga Qendra për Arte Pamore “Multimedia” mes viteve 2010-2012. Ky projekt ka marrë shumën prej 93.000 € nga kjo skemë me qëllim të shfrytëzimit të artit si instrument për dialog mes komuniteteve etnike në Kosovë.

Analiza e gjendjes: Effektiviteti e instrumenteve financiare të KE-së që përkrahin sektorin e pavarur të kulturës

Në pjesën paraprake u theksua se aktualisht ekzistojnë disa instrumente, përmes të cilave operatorët e kulturës mund të gjejnë përkrahje financiare dhe teknike. Megjithatë, derisa për disa instrumente problemi kryesor ka të bëjë me qasjen (pra, me programin Evropa Kreative), për instrumente të tjera çështja është a kanë qenë deri më tani në gjendje të ofrojnë përkrahje të vlefshme për aktivitete cilësore të kulturës dhe ngritje të kapaciteteve për operatorët e kulturës. Çka është edhe më e rëndësishme: a janë skemat e tanishme të efektshme sa duhet për përkrahjen e operatorëve që të jenë konkurrues në nivel evropian?

Hulumtimi i bërë për këtë dokument, në bazë të intervistave me palët e ndryshme me interes dhe të analizës së burimeve dytësore,

tregon se përgjigja në këtë pyetje është disi e përzier. Shumica e problemeve fillojnë nga nivelet e larta të politikave të ndërveprimit mes KE-së dhe Kosovës, të cilat nga ana tjetër ndikojnë në cilësinë e programeve dhe në mjedisin e punës së operatorëve të kulturës.

Pikësëpari, rrënja e problemit duket të jetë në prioritetizimin e pamjaftueshëm të kulturës në nivel të ndërveprimit të politikave mes Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Kosovës. Raporti mes dy palëve përcaktohet nga procesi i përfundimit me BE-në. Ky proces nga ana tjetër përcaktohet nga paradigma e kushtëzimit. Gjegjësisht, vendet që dëshirojnë të anëtarësohen në BE duhet të fillojnë procesin e reformave institucionale dhe të tregut për të qenë në përputhje me standardet e legjislacionit të BE-së (“Acqui”). Për këtë qëllim caktohen standardet, arritja e të cilave matet vazhdimisht përmes raporteve vjetore të progresit, të hartuara nga

KE-ja. Instrumentet për përkrahje financiare, siç është IPA (Instrumenti i paraaderimit) janë gjithashtu të krijuara në kuadër të përpjekjeve të përbashkëta mes KE-së dhe qeverisë për të përkrahur agjendën e integritit. Ato gjithashtu prioritetizojnë investimet në arkitekturën fizike dhe institucionale që nevojitet për përkrahjen e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik.

Çështja e kulturës kushtimisht mbetet nën radar si në kuadër të agjendës së përafrimit, ashtu edhe në atë të zhvillimit brenda ndërveprimeve formale mes BE-së dhe Kosovës. Kultura nuk është pjesë e “aqi të BE-së” dhe rrjedhimisht as e pakos së kushteve. Në Raportin e progresit të KE-së për Kosovën 2014, fjala kulturë përmendet vetëm dy herë, dhe atë vetëm shkarazi lidhur me monitorimin e aktiviteteve të qeverisë.⁹

⁹ Komisioni Evropian. “Raporti i progresit për Kosovë 2014” http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

Kjo do thotë që kultura, dhe veçanërisht përkrahja për sektorin e pavarur të kulturës, nuk është nga ato fushat ku qeveria ballafaqohet me presione për të hyrë në çfarëdo reforme të mirëfilltë apo për të arritur ndonjë synim të performancës. Sektori i kulturës preket nga kushtëzimet vetëm në kuadër të reformave të përgjithshme për qeverisje të mirë dhe administratë publike që vlejné për të gjithë sektorët. Mungesa e çfarëdo ndikimi nga jashtë është e rëndësishme në një mjedis të politikave ku llogaridhënia nga poshtë-lartë është e vogël. Sektori i pavarur i kulturës është i dobët, pak i bashkërenduar dhe jo i fuqishëm sa duhet për t’u angazhuar me qeverinë në sigurimin e një qasjeje më strategjike në vendimmarrje dhe financim më të madh.¹⁰

Po ashtu, në kuadër të programeve aktuale të IPA-s nuk trajtohet sektori i kulturës si një sektor që ka rol

¹⁰ Përfundimet e nxjerra nga intervistat dhe raportet e shqyrtimit të Forumit të Kulturës.

të rëndësishëm në agjendën shoqërore dhe zhvillimore të Kosovës. Kjo ndodh përkundër faktit që kultura ka treguar se mund të luaj rol të rëndësishëm në strategjitë zhvillimore të disa vendeve si një gjenerator i turizmit kulturor dhe si një instrument për diplomaci publike. Një studim i Institutit GAP, për shembull, thekson se qyteti i Prizrenit mund të fitojë edhe deri në 3.8 milionë € në vit nga festivali ndërkombëtar i filmit dokumentar Dokufest.¹¹ Është i tepërt të ceket ndikimi i tërthortë i festivaleve ndërkombëtare në Kosovë dhe i paraqitjeve ndërkombëtare të artistëve të Kosovës në përmirësimin e imazhit ndërkombëtar të Kosovës.

Rëndësia e kulturës për zhvillim pasqyrohet në dokumentin Konsensusi evropian për zhvillim (2005), dokument ky kryesor strategjik në të cilin bazohet politika zhvilli-

more e BE-së. Në këtë dokument kultura konsiderohet “si sektor në vetvete i zhvillimit njerëzor” dhe, rrjedhimisht, sektor që ia vlen të përkrahet. Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian – baza kushtetuese e BE-së – gjithashtu vë theks të fuqishëm në rëndësinë e angazhimit të BE-së në fushën e kulturës, kur thuhet se “BE-ja kontribuon në lulëzimin e kulturës në shtetet anëtare të saj, duke respektuar njëkohësisht larminë e tyre kombëtare dhe regjionale, si dhe duke sjellë trashëgiminë e përbashkët kulturore në rend të parë.”¹²

Problemi i dytë kryesor në nivel të politikave është mënyra e trajtimit të sektorit të kulturës nga institucionet e BE-së si një instrument për arritjen e objektivave të tjera të politikave, posaçërisht të dialogut ndëretnik dhe të përfshirjes së grupeve të cenueshme. Madje edhe në programet e përcaktuara

11 Institutit GAP. “Ndikimi ekonomik i Dokufestit”. 2012 http://www.dokufest.com/2012/repository/docs/The_Economic_Impact_of_DokuFest.pdf

12 Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian (Treaty on the Functioning of the European Union).

për kulturë, sektori i kulturës më shumë trajtohet si mjet drejt arritjes së një qëllimi të caktuar dhe jo si qëllim në vetvete. Me përjashtim të komponentit të parë të programit Kultura për të gjithë, mundësitë ekzistuese të financimit për sektorin e kulturës zakonisht janë ato që ndërliken me kushtet tematike, siç është promovimi i pajtimit, demokratizimi dhe avokimi për shoqërinë civile.

Asnjë nga këto instrumente nuk kanë për qëllim përkrahjen e sektorit të pavarur të kulturës nga një pikëpamje më strategjike, përmes së cilës do t'u mundësohej organizatave të pavarura kulturore nga niveli bazë që të sigurojnë qëndrueshmëri afatgjatë dhe t'i fuqizojnë kapacitetet. Sipas operatorëve të kulturës, futja e shumë kushteve tematike çon drejt aktiviteteve të udhëhequra nga donatorët apo në krijimin e gjendjes ku operatorët e kulturës më serioz, cilësorë dhe strategjikë, pra ata që

kanë mundësi të bëhen konkurrues në aspektin botëror, detyrohen të konkurrojnë për fonde të pakta me iniciativa të vogla dhe margjinale, të cilat plotësojnë kriteret tematike.

Sfida e tretë kryesore e identifikuar në nivel të politikave është angazhimi i pamjaftueshëm i komunitetit të kulturës në përpjekjet e avokimit tek KE-ja dhe institucionet e Kosovës lidhur me trajtimin e shqetësimeve të veta. Një angazhim më i fortë dhe sistematik ndoshta ka mundur të ketë një dozë ndikimi në rritjen e prioritetizimit të kulturës dhe të cilësisë së programeve të BE-së për këtë sektor.

Ndoshta ky angazhim ka mundur t'i bënte institucionet komunale më të zëshme në avokimin për interesat e operatorëve të kulturës me homologët e tyre në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe në Bruksel, duke përfshirë këtu përfshirjen e Kosovës në programin Evropa Kreative. Vështirë është të

pritet që KE-ja do të dijë se për çka ka nevojë, si dhe për Qeverinë e Kosovës të avokojë për ato objektiva, nëse komuniteti i kulturës nuk angazhohet vet në mënyrë aktive në avokim rreth politikave dhe në dialog, si dhe nëse nuk kërkon llogaridhënie prej qeverisë.

Sfida e katërt dhe sipas shumicës më e rëndësishmja në nivel të politikave është mosekzistimi i qasjes strategjike dhe ambicia e vogël në politikën e kulturës nga ana e Qeverisë. Kjo çon në vlerësimin e ulët të faktit se donatorët ndërkombëtarë, posaçërisht Komisioni Evropian, mund të jenë partner serioz financiar për një qasje më ambicioze ndaj politikave dhe programeve të kulturës.

Po ashtu, ekziston nevoja që të shkohet përtej praktikës së shpërndarjes vjetore të subvencioneve të vogla, të cilat sipas një studimi të bërë së fundi, nuk janë të ndërlidhura me ndonjë objektiv apo kriter


strategjik.¹³ Mospasja e një qasjeje të tillë strategjike ndaj politikës dhe programeve të kulturës ka krijuar një gjendje ku operatorët e pavarur të kulturës, të cilët në shumë raste janë më produktiv se institucionet publike të kulturës, trajtohen vetëm si OJQ që kanë nevojë për përkrahje rreth një aktiviteti të caktuar, por jo edhe për përkrahje institucionale. Një qasje më e logjikshme do t'i konsideronte operatorët e pavarur si institucione po aq të vlefshme sa institucionet publike, të cilat në një afat të gjatë kanë potencialin të bëhen të vetëqëndrueshme apo madje edhe t'u prijnë institucioneve kulturore të vendit.

Këto katër probleme kryesore në nivel të politikave të ndërveprimeve mes KE-së dhe Kosovës kanë krijuar vështirësi në terren për operatorët e kulturës dhe sektorin e kulturës në përgjithësi. Këto vështirësi kanë të bëjnë

¹³ Pozhegu, Dren. "Politikat e kulturës dhe ndarjet buxhetore për kulturë në Kosovë" – Forumi Kulturor, Tetor 2014. http://www.forumikulturor.net/repository/docs/Cultural_Policies_and_Budget.pdf

me kufizimin e potencialit për mundësi të financimit, duke e prishur natyrën e bazës së aktiviteteve kulturore përmes futjes së kushteve tematike, duke mos bërë ndarjen e mjaftueshme mes operatorëve cilësorë dhe strategjikë – të gjitha këto në dëm të përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve dhe të qëndrueshmërisë së sektorit të pavarur të kulturës. Marrëdhënia

shkakore e këtyre problemeve është ilustruar në mënyrë grafike në të ashtuquajturën pemën e problemeve më poshtë (shih figurën 1). Pema e problemeve ndan (në të kuqe) problemet imediate në ndërveprimet mes KE-së dhe skenës së pavarur të kulturës, dhe ato afatgjata (në të zezë) që do të ndikojnë këtë ndërveprim kur Kosova t'i bashkohet programit Evropa Kreative.



Të kuptuarit e shkaqeve dhe pasojave të problemeve në raportet mes BE-së dhe Kosovës është i rëndësishëm posaçërisht në këtë moment kur këto raporte pritet të avancohen në nivel më të lartë pas përfshirjes së mundshme të Kosovës në programin Evropa Kreative. Çështja kryesore nuk është aktualisht nëse apo kur operatorët nga Kosova do të kenë të drejtë të konkurrojnë për këtë program sepse kjo duhet të ndodhë sapo të nënshkruhet MSA-ja dhe marrëveshja kryesore kornizë, por çështja kryesore është nëse operatorët e kulturës do të jenë konkurrenues sa duhet për t'u futur në garë me projektet nga mbarë Evropa, të udhëhequra nga operatorët me përvojë të konsiderueshme në menaxhimin e kulturës dhe në zbatim.

Kjo është arsyeja se pse në një afat të shkurtër dhe të mesëm, agjenda e politikave dhe e programeve e qeverisë dhe donatorëve duhet të fokusohet në masat e nevojshme,

përmes të cilave do të sigurohet që operatorët e kulturës të kenë kapacitetet e duhura për ruajtjen apo rritjen e nivelit të tyre të konkurrueshmërisë. Roli i qeverisë është shumë i rëndësishëm, duke pasur parasysh që është ofrues i përkrahjes financiare për sektorin e kulturës dhe se ka ndikim në prioritetet programore për Kosovë.

Disa operatorë me kalimin e viteve kanë fituar një përvojë dhe historik të mirë në menaxhimin e projekteve që do të jetë e dobishme kur të vjen koha e aplikimit për fonde të mëdha evropiane. Megjithatë, ata ballafaqohen me një numër sfidash të mëdha. Nëse nuk marrim parasysh çështjen e programeve cilësore, ku ekziston një dallim i madh mes operatorëve, pothuajse të gjithë ballafaqohen me probleme të ngjashme që sillen rreth trekëndëshit stabilitet financiar, kapacitete teknike dhe menaxhim jo i duhur.

Edhe operatorët më të konsoliduar dhe me potencial konkurrues mbesin shumë të cenusshëm përderisa kostot më themelore operacionale varen shumë nga përkrahja afatshkurtër dhe afatmesme e projekteve përmes subvencioneve të qeverisë, granteve të donatorëve dhe disa aktiviteteve komerciale (p.sh. bare dhe kafeteri). Të hyrat nga këto burime janë të pasigurta prej vitit në vit gjë që e bën të vështirë hartimin e planeve afatgjata, si dhe investimin e kohës dhe të burimeve në kapacitetet e punonjësve apo në zhvillimin e projekteve të reja. Përmes financimeve të filla të bazuara në projekte shumica e operatorëve aktualisht mbulojnë kostot themelore operacionale, siç është qiraja për zyra (nëse kanë mundësi ta kenë ndonjë), shpenzimet komerciale dhe punëtorët kryesorë, për të cilët puna në sektorin e kulturës është gjithmonë e pasigurt që rrjedhimisht përkushtimin ndaj saj e bën të vështirë.

Punonjësit e këtyre operatorëve zakonisht janë vet artistët, gjë që është problem në vetvete, pasi që duhet të mundohen të arrijnë si standardet artistike, ashtu edhe ato organizative. Kjo situatë e ka bërë pothuajse të pamundur gati për të gjithë operatorët që të ndajnë funksionet operacionale nga ato programore. Kjo ndarje është kritike për të mundësuar si programet cilësore, ashtu edhe zhvillimin e administratave profesionale dhe të strukturuar të ngjashme me ato të kolegëve të tyre në vendet evropiane. Njeriu a ka të vështirë të jetë kreativ dhe të hulumton ide të reja, derisa merret me punët e përditshme të administratës.

Një nga arsyet e kësaj cenusshmërie është fakti se programet ekzistuese të qeverisë dhe donatorëve, duke përfshirë Kulturën për të gjithë, nuk kanë marrë parasysh sa duhet nevojat institucionale të operatorëve të pavarur të kulturës, të cilat janë tepër të

rëndësishme për suksesin e tyre afatgjatë. Më herët është theksuar se njëri nga arsyet e fillimit të projektit Kultura për të gjithë nuk ishte vetëm përkrahja e aktiviteteve kulturore, por edhe në afat të gjatë të shërbejë si një lloj i ure financiare për përkrahje të mjaftueshme të operatorëve të kulturës në mënyrë që të fitojnë përvojë fillestare të projekteve dhe të ngritjes së kapaciteteve, e cila nga ana tjetër do t'ua mundësojë atyre të bëhen konkurrentë në nivel të industrisë kulturore evropiane.¹⁴

Gjatë fazës së hershme, në kuadër të projektit është bërë identifikimi i hollësishëm i operatorëve të kulturës suke i intervistuar 130 syresh.¹⁵ Kjo ka çuar në identifikimin e disa operatorëve me reputacion dhe potenciale më të konsoliduara për realizimin e aktiviteteve më afatgjata. Këta operatorë kanë marrë përkrahje financiare pothuajse në

çdo vit të projektit (p.sh. Dokufest) përmes komponentit të parë të skemës së granteve ku janë dhënë shuma më të mëdha (5,000 € deri në 9,000 €).

Derisa shumica konsiderojnë se një përkrahje e fillë financiare ka qenë shumë e dobishme në mundësimin e këtyre operatorëve më të pjekur dhe me pikëpamje ndërkombëtare të organizojnë aktivitetet e tyre vit pas viti dhe të pasurojnë repertorin e tyre, prapëseprapë ka qenë e pamjaftueshme, duke pasur parasysh fushëveprimin e aktiviteteve të tyre, kufizimet e kapaciteteve dhe ambiciet afatgjata strategjike.

Sipas disa prej operatorëve më të mëdhenj dhe më të njohur të kulturës, skema e granteve e projektit Kultura për të gjithë ka pasur problem të njëjtë siç ka qenë rasti edhe me skemën e granteve të realizuar nga Ministria e Kulturës: pra, ky problem kishte të bënte me shpërndarjen e gjerë të fondeve ("duke

14 Intervistë me ish-zyrтарin e Qeverisë që ka qenë aktiv në diskutimet për krijimin e programit.

15 Informata e nxjerrë nga intervista.

u ndihmuar të gjithëve, por duke mos i dhënë ndihmë askujt”) dhe me shtimin e objektivave të tjera të politikave (dialogu ndëretnik, etj) një pjese të madhe të mjeteve të parapara për financim. TKjo i ka vënë operatorët e kulturës në pozitë që të udhëhiqen nga donatorët apo që fare të mos marrin financime për shkak të mosplotësimit të kriterëve tematike.

Për shembull, në vitin 2014 Ministria e Kulturës ka përkrahur 266 projekte me një shumë mesatare prej 2,900 €. Ngjashëm me këtë, në vitin 2014 në kuadër të programit Kultura për të gjithë janë shpërndarë rreth 200,000 € për 34 projekte, ku shumica prej tyre kanë pasur komponentin ndëretnik. Për këtë të fundit, numri, shpërndarja gjeografike dhe larmia e përfituesve duket të ketë qenë kriter më i rëndësishëm sesa cilësia dhe ndikimi afatgjatë në sektorin e pavarur të kulturës.

Të dyja këto skema të përkrahjes financiare konsiderohen prej disa operatorëve më të konsoliduar dhe profesional të kulturës si jo strategjike sa duhet sepse kanë dështuar që sado kudo të diferencojnë cilësinë e përfituesve – gjegjësisht të dallojnë operatorët që kanë potencial më afatgjatë për të pasur ndikim të gjerë në sektorin e kulturës dhe aktiviteteve të izoluar margjinale me ndikim të ulët.

Kundërargumenti i bërë gjatë hulumtimit nga pikëpamja e donatorëve dhe qeverisë ishte se operatorët më cilësorë tanimë kanë fonde të mjaftueshme për të bërë atë që dëshirojnë ta bëjnë, kështu që ka qenë veprim i mençur dhe i drejtë që edhe të tjerëve t’u jepet mundësia. Përderisa ekziston argumenti kundër monopolizimit dhe për krijimin e mundësive të barabarta, nga këndvështrimi strategjik po ashtu është e vërtetë se përkrahja e rritur financiare do të mund të ndihmonte që operatorët

cilësorë të bëjnë punën e tyre edhe më mirë. Nëse ndihma jepet në formë të granteve institucionale, kjo do t'ju ndihmonte të bëhen më të vetëqëndrueshëm në një afat të gjatë dhe më konkurrues në aspektin ndërkombëtar.

Mungesa e një përkrahjeje të tillë në formë të granteve institucionale dhe lënia e operatorëve të cënueshëm ndaj tronditjeve të papritura financiare krijon rrezikun që çkado që është arritur deri më tani në kuptim të ngritjes së kapaciteteve të shkatërrohet apo që operatorët të mos jenën gjendje të bëjnë hapat e nevojshëm drejt niveleve më të larta të cilësisë në menaxhim ose në aktivitete. Tërheqja e skemës granteve për kulturë të organizatës Pro Helvetia para ca vitesh tregoj se si shkuarja e vetëm një donatori nga skena mund të lë një boshllëk të madh dhe t'i shkaktoj dëme sektorit.¹⁶ Duke pasur parasysh këtë përvojë, ka arsye për t'u frikësuar që pas

16 Informata e nxjerrë nga intervista.

përfundimit të programit Kultura për të gjithë në vitin 2016 të ndodh i njëjti efekt.

Programi Kultura për të gjithë ka pasur komponentin për ngritjen e kapaciteteve pasi që ka përkrahur studimet sektoriale, këmbimin e mundësive, trajnimet për menaxhim, etj. Megjithatë, shkalla e këtij komponenti është konsideruar e pamjaftueshme, duke pasur parasysh se barra kryesore për kapacitete është cënueshmëria financiare dhe institucionale. Kjo është arsyeja pse është shumë e rëndësishme qoftë për qeverinë apo për donatorët të fusin grantet institucionale shumëvjeçare për mbulimin e shpenzimeve themelore operacionale apo për ofrimin e kontributeve në natyrë (në formë të hapësirës për zyra, etj).

Mekanizmat e tjerë për përkrahjen e ngritjes së kapaciteteve janë pjesë e pandashme e programit Evropa Kreative. Pasi që Kosova t'i bashko-

het këtij programi, do të obligohet sikurse të gjitha vendet e tjera në regjion që përmes Marrëveshjes kornizë të themelojë Deskun kreativ, i cili do të jetë pikë kontakti dhe lehtësimi për operatorët e kulturës lidhur me DP për kulturë. Desku kreativ ofron përkrahje teknike për një numër shërbimesh, duke përfshirë edhe procedurat e aplikimit që shpesh janë mjaft të ndërlikuara dhe shkrimin e formatit të projektit. Edhe pse Kosova ende nuk është pjesë e Evropës Kreative, do të mund të fillonte procesin e krijimit të Deskut kreativ edhe më herët – do të preferohej që të jetë jashtë Qeverisë, ku Forumi Kulturor do të ishte vendi optimal si organizatë ombrellë.

Rekomandimet

Në nivel të makropolitikave, rekomandimi i përgjithshëm është se sektorit të kulturës duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje si nga institucionet e Kosovës, ashtu edhe nga Komisioni Evropian

gjatë planifikimit të politikave dhe programeve. Edhe pse agjenda e raporteve mes Kosovës dhe BE-së dominohet nga një numër çështjesh me prioritet më të lartë – siç janë dialogu me Serbinë, negociatat për MSA-në, liberalizimi i vizave, agjenda zhvillimore, etj – nevoja e përkrahjes së sektorit të kulturës duhet së paku të figurojë diku në hartën e çështjeve të rëndësishme. Zhvillimi i një sektori të fortë të pavarur të kulturës posaçërisht duhet të trajtohet si qëllim në vetvete, me potencial për dhënie të kontributit, në mes të tjerash, në rritjen ekonomike të Kosovës, sikurse edhe çdo sektor tjetër.

Në nivel praktik, duhet të ketë ndryshme në mënyrën se si KE-ja dhe posaçërisht institucionet e Kosovës, i hartojnë politikat dhe programet e tyre në përkrahje të sektorit të pavarur të kulturës. Përkrahja financiare dhe format e tjera të përkrahjes duhet të jenë më strategjike dhe të kenë për qëllim

t'u ofrojnë operatorëve të kulturës kapacitete për t'u bërë institucione të qëndrueshme dhe të pavarura që do të ishin të gatshme të bëjnë hapa cilësorë. Operatorët e pavarur të kulturës, posaçërisht ata që kanë treguar sukses në punën e tyre, nuk duhet të trajtohen vetëm si OJQ që kanë nevojë për subvencion periodik të aktiviteteve të tyre, por si të barabarta me institucionet publike të kulturës që kërkojnë përkrahje institucionale dhe të aktiviteteve. Një përkrahje e tillë do t'u jepte operatorëve të kulturës mjetet për fuqizimin e kapaciteteve të brendshme, mundësinë për punësim të punëtorëve të përhershëm, mundësinë për ndarjen e funksioneve artistike nga ato administrative, të angazhimit në planifikime afatgjata, etj. Sa i përket ndërveprimeve mes Kosovës dhe BE-së, kjo do të ndihmonte në përgatitjen e operatorëve të kulturës në Kosovë për tregun shumë konkurrues kulturor të Evropës në momentin kur të bëhet e mundur qasja në fondet e

BE-së për kulturë.

Në mënyrë që ky ndryshim në qasje të ketë sukses duhet të plotësohen disa parakushte. I pari është fakti se duhet të ketë qasje strategjike dhe kriteret e qarta në përcaktimin se cilët operatorë dhe cilët sektorë të kulturës meritojnë përkrahjen. Miratimi i Strategjisë kombëtare për kulturë që ende nuk është bërë, do të kishte rëndësi thelbësore. Parakushti i dytë është ndryshimi i mënyrës së shpërndarjes së granteve të parapara për sektorin e kulturës. Duhet të ketë harmonizim më të madh mes skemave të ndryshme të përkrahjes, duke përfshirë bashkërendimin mes granteve institucionale të KE-së dhe të Kosovës, si dhe të shmanget qasja e shpërndarjes së gjerë të granteve të vogla për projekte, dhe të shkohet drejt qasjes ku grantet më të mëdha institucionale shumëvjeçare u jepen operatorëve me rëndësi strategjike. Dhe në fund, por jo më pak e rëndësishme,

për t'iu shmangur sjelljeve të udhëhequra nga donatorët, kriteret siç është avancimi i dialogut ndëretnik dhe pajtimi, sado që janë për t'u lavdëruar, duhet gjithnjë e më pak të përfshihen në skema të granteve.

Suksesi domethënës i sektorit të pavarur kosovar të kulturës në skenën evropiane, pavarësisht sfidës së kapaciteteve të brendshme, varet prej qasjes në fondet e BE-së. Qasja e Kosovës në programin Evropa Kreative duhet të jetë çështje e prioritetit për qeverinë e re, dhe e njëjta duhet të ngritet gjatë bisedave me KE-në dhe me shtetet anëtare veç e veç. Pasi që Marrëveshja kornizë me DP për kulturë parasheh ndarjen e fondeve për program, duhet të fillohet procesi i brendshëm buxhetor për t'iu siguruar që Kosova të jetë e gatshme. Sektori i pavarur i kulturës gjithashtu duhet të mobilizohet për të monitoruar interesat e veta dhe avokuar për to brenda këtij procesi mjaft të rëndësishëm.

FORUMI KULTUROR

Gjatë fundit të vitit 2011, Teatri Oda ka mbajtur takime të shumta me qëllim të themelimit të rrjetit të organizatave të kulturës në Kosovë. Në këto takime kanë marrë pjesë më shumë se 60 pjesëmarrës, përfaqësues të organizatave të ndryshme të kulturës, duke krijuar kështu mundësinë për të organizuar Kuvendin themelues më 23 mars 2012, ku u vunë themelet për Rrjetin e Organizatave të Pavarura të Kulturës – Forumi Kulturor. Kuvendi themelues vuri themelet e Forumit Kulturor me 22 organizata të pavarura si anëtare. Përmes votimit demokratik është miratuar Statuti dhe gjithashtu është zgjedhur kryesia e Rrjetit. Forumi Kulturor është entitet i regjistruar si rrjet i organizatave të pavarura të kulturës. Këtu është vendosur që rolin e Sekretarisë së përkohshme ta merr Teatri Oda deri në krijimin e kapaciteteve për formimin e sekretarisë profesionale të rrjetit.

Forum i Kulturor i Kosovës është rrjet i organizatave të pavarura të

kulturës në Kosovë, i themeluar me qëllim të:

- Fuqizimit të organizatave të pavarura të kulturës përmes zhvillimit të kapaciteteve për zbatimin e programeve të tyre;

- Promovimit të organizatave anëtare;

- Përfshirjes së organizatave anëtare në vendimmarrje;

- Rritjes së përkrahjes për skenën e pavarur kulturore;

- Mbrojtjes dhe përmirësimit të pozitës së organizatave kundruall institucioneve përkatëse në Kosovë dhe jashtë saj.

Forum i kulturor ka për qëllim të plotësojë misionin e tij përmes aktiviteteve si në vijim:

- Komunikimin dhe rrjetëzimin e organizatave të pavarura të kulturës;

- Këmbimin dinamik të informatave dhe të përvojës;

- Aktivitetet e lobimit dhe avokimit;

- Trajnime specifike për nevo-

jat e organizatave anëtare;
-Organizmin e debateve dhe
forumeve dhe
-Bashkërendimin e aktiviteve artistike dhe të kulturës.

FORUMI PËR ZHVILLIMIN E KULTURËS

Forumi për Zhvillim Kulturor është projekt që ka për qëllim të zhvillojë dhe fuqizojë më tej Forumin Kulturor të themeluar në vitin 2012, duke dhënë këshilla dhe ekspertizë të vlefshme për politikat kulturore të Kosovës. Projekti përkrahet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, ndërsa zbatohet nga Forumi Kulturor, Teatri Oda dhe Dokufest-i. Aktivitetet e para të projektit u realizuan në dhjetor të vitit 2013. Projekti parashihet të zgjasë deri në nëntor 2015. Gjatë kësaj periudhe dyvjeçare, Forumi për Zhvillim Kulturor do të del me së paku 28 produkte të politikave kulturore, të cilat do të rezultojnë nga hulumtimet, debatet, grupet e fokusit dhe konferencat. Në kuadër të projektit gjithashtu do të fuqizohet rrejtja e organizatave të pavarura të kulturës, do të ndërtohen kapacitete e tij të brendshme dhe do të ndikohet në zhvillimin e politikave të kulturës në Kosovë duke krijuar dije për kulturën. Përveç kësaj, në kuadër të projektit do të nxitet dialogu dhe

bashkëpunimi mes sektorit të kulturës së pavarur dhe autoriteteve publike në mënyrë që të gjenden zgjidhjet konkrete për zhvillimin e kulturës në Kosovë.

www.forumikulturor.net



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



SWEDEN


Implementuar nga:



FORUMI
KULTUROR

Rregullt i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës





forumikulturor.net
facebook.com/ForumiKulturor
twitter.com/forumikulturor